



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



SHPALLJE PUBLIKE PËR ANËTAR TË KËSHILLIT DREJTUES TË QENDRËS KULTURORE TË PRISHTINËS

Në bazë të Nenit 10 të Statutit të Qendrës Kulturore të Prishtinës me nr.01-030//01-0263806/18,më 01.11.2018 drejtorja për Kulturë hap Shpalljen Publike për :

1. Një anëtar/e, përfaqësues nga Shoqeria civile për këshillin drejtues të Qendrës Kulturore të Prishtinës.

Ftojme të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët nuk janë nën hetime apo me precedent penal, dhe që kanë përvojë në shoqërinë civile, të aplikojnë për anëtarë të këshillit drejtues të Qendrës Kulturore të Prishtinës.

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues:

- Rekomandon ndryshime në Statutin e QKP-së dhe miraton rregulloret dhe aktet të tjera nënligjore të QKO-së;
- Mbikqyrë punën e QKP -së;
- Miraton planprogramin e përgjithshëm të QKP-së;
- Ndihmon në planprogramin e degëve të QKP-së;
- Shqyrton dhe miraton raportin financiar të QKP-së;
- Interviston kandidatët dhe zgjedh drejtor/in -en e QKP-së;
- Monitoron punën e degëve të QKP-së;
- Mbikqyrë përzgjedhjen e udhëheqës/it-es programor/artistik;
- Përfaqësohet në Këshillin drejtues të degëve të QKF -së;
- Inicon procedurë dhe shkarkon drejtor/in-en;
- Këshilli drejtues merr vendime me shumicë absolute votave të gjithë anëtarëve të pranishëm;
- Për punën e tij përgjigjet drejtor/it-es së Kulturës Komunes së Prishtinës.

Përfaqësues/i-ja e lartcekur që përzgjedhet, do të jetë anëtarë i Këshillit Drejtues të Qendrës Kulturore të Prishtinës, ku do të kryej detyrat dhe përgjegjësitë konform procedurave të rregullta administrative dhe Statutit të Qendrës Kulturore të Prishtinës.

Aplikuesit duhet të jenë persona me përvojë profesionale në fushën e lartcekur.

Të gjithë të interesuarit në këtë proces aplikimi , duhet të dërgojnë CV e tyre në postën elektronike zyrtare kultura.pr@rks-gov.net

Aplikimi fillon me datë **23.04.2021** dhe do të zgjasë deri më **29.04.2021**.

Për më shumë informata na kontaktoni në numrin e telefonit **038/226-417** dhe **038 230 900 -lok: 1141**.